



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 14.3.2023

Nr: 174

Ora: 16:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR REGJISTRIMIN E KOMITETIT NISMËTAR QË DO ORGANIZOJË PUNËN PËR PARAQITJEN E Z. ARLIND MUHAMET QORI, SI KANDIDAT I PROPOZUAR NGA ZGJEDHËSIT NË ZONËN ZGJEDHORE BASHKIA TIRANË, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë, 14.3.2023 në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me nr. 1393 Prot, datë 06.03.2023 me:

Kërkues: 1-Albina Besja Ruko, 2-Alfred Zef Bushi, 3-Anxhela Maksim Nasto, 4-Arsita Fatos Mati 5-Aumiraldi Vehbi Dalliu, 6- Demian Dedë Mrishaj, 7-Esi Agim Zaimi, 8-Kristiana Frrok Kola, 9-Redi Arjan Kociaj.

Objekti: Kërkohej regjistrimi i Komitetit Nismëtar, për paraqitjen e z. Arlind Muhamet Qori, si kandidat i propozuar nga zgjedhësit për Kryetar Bashkie, në zonën zgjedhore Bashkia Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Baza ligjore: Neni 70 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 Maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Data: 14.3.2023 Nr: 174
Ora: 16:00



“Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e Komitetit Nismëtar që do të organizojë punën për paraqitjen e z. Arlind Muhamet Qori, si kandidat i propozuar nga zgjedhësit për Kryetar Bashkie në zonën zgjedhore Bashkia Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

Në referim të nenit 70, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, grupi i zgjedhësve i përbërë nga Albina Besja Ruko, Alfred Zef Bushi, Anxhela Maksim Nasto, Arsita Fatos Mati, Aumiraldi Vehbi Dalliu, Demian Dedë Mrishaj, Esi Agim Zaimi, Kristiana Frrok Kola, Redi Arjan Kociaj, i është drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me kërkesën me nr. 1393 Prot., datë 06.03.2023, dhe me kërkesën nr. 1393/1 Prot., datë 08.03.2023, për regjistrimin e Komitetit Nismëtar të formuar prej tyre.

Kërkuesit kanë depozituar emrat dhe nënshkrimet e tyre si dhe i kanë bashkëlidhur kërkesës kopjet e dokumentave të identifikimit.

Nga verifikimi i emrave të kërkuesve në ekstratin e përbërësve zgjedhorë rezulton se, janë zgjedhës të zonës zgjedhore Bashkia Tiranë, dhe me vullnet të lirë kanë vendosur krijimin e Komitetit Nismëtar për organizimin e punës për mbledhjen e firmave mbështetëse për kandidatin për kryetar bashkie z. Arlind Muhamet Qori.

Në përfundim, kërkesa e paraqitur prej këtyre zgjedhësve përmbush kriterin dhe afatin e përcaktuar në nenin 70, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, 70, pika 3 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar,

VENDOSA:

1. Regjistrimin e Komitetit Nismëtar që do të organizojë punën për paraqitjen e z. Arlind Muhamet Qori, si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Bashkia Tiranë, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI